



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 1098/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Blerim Nikqi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), dega në Pejë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Blerim Nikqi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga koalicioni (AAK-LDD) dega në Pejë.

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Blerim Nikqi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal (AAK-LDD) dega në Pejë, në të cilën theksohet se në të paktën 10 Vendvotime numri i votave që i ka shpall KQZ-ja është më i vogël se sa numri i votave që realisht kam marrë, gjithashtu thekson se vëzhguesit e tij dhe të subjekteve tjera kanë konstatuar se numri i votave që kam është mbi 700, ndërsa votat me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta nuk më janë numëruar, dhe duke u bazuar në këto fakte dyshoj se si kandidat jam dëmtuar të paktën në këto Qendra të Votimit : 1703/02R me 3 vota, 1705C/06R me 1 votë, 1706C/05R 2 vota, 1706C/06R 1 votë, 1708C/01R 2 vota, 1708/02R 1 votë, 1713C/03R 6 vota, 1724C/01R 3 vota, 1727C/01R 1votë , 1727C/03D 1 votë. Gjithashtu kërkon që të rishikohen votat e kandidatëve tek votuesit me nevoja te veçanta, sepse sipas dëshmimeve që mi kanë dhënë votuesit aty duhet ti kem në mes 13-14 vota gjithashtu vota me kusht duhet të jenë 16.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se nga verifikimi dhe shqyrtimi i materialit zgjedhor nuk ka mundur që të vertetoj pretendimet e parashtruara në ankesë dhe se ngase provat e bashkangjitura nuk janë të mjaftueshme dhe prova zyrtare, për ti vërtetuar pretendimet ankimore të parashtruara me

ankesë andaj mbi këtë bazë PZAP, konsideron se ankesa është e pabazuar dhe e paargumentuar në prova dhe dëshmi bindëse prandaj PZAP-i, në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr.1098/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridike:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda njezetekater (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.